



Република Северна Македонија

Министерство за финансии

MFRMV.F.8.5/9-2

LËVIZJET EKONOMIKE AFATSHKURTRA



Shkurt, 2025



PËRMBAJTJA

P Ë R M B L E D H J E	2
1. SEKTORI REAL	3
Prodhim industrial.....	3
Numri i të punësuarve në industri	4
Çmimet e shitjes së prodhuesve të produkteve industriale në tregun vendor	5
Indeksi i qarkullimit në industri	6
Numri i lejeve të lëshuara të ndërtimit dhe vlera e paraparë e objekteve.....	6
Numri i punëve të kryera ndërtimore sipas llojeve të objekteve	7
Qarkullimi në sektorin e tregtisë	8
Inflacioni	8
Çmimet e bursës.....	10
2. SHKËMBIMI I JASHTËM TREGTAR.....	12
Eksporti.....	12
Importi.....	13
Saldoja e shkëmbimit tregtar.....	14
Struktura valutore.....	15
3. SEKTORI FISKAL.....	15
Të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore sipas klasifikimit ekonomik	15
Shpenzimet sipas shfrytëzuesve buxhetorë	18
4. SEKTORI SOCIAL	19
Personat e sapopunësuar dhe personat e regjistruar si të papunë në Agjencinë e Punësimit.....	19
Pagat.....	20
Pensionet	21
5. SEKTORI MONETAR FINANCIAR.....	22
Paratë primare	22
Potenciali i depozitave	22
Kreditë e bankave.....	23
Normat e interesit të bankave depozituese	24
Tregu i kapitalit.....	24
Rezervat devizore.....	25



P Ë R M B L E D H J E

E L Ë V I Z J E V E M Ë T Ë R Ë N D Ë S I S H M E E K O N O M I K E A F A T S H K U R T R A

Shkurt, 2025

- Në muajin shkurt të vitit 2025, prodhimi industrial ka shënuar rënie prej 0.8% krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak;
- Në muajin shkurt të vitit 2025, çmimet e shitjes së produkteve industriale të prodhuesve në tregun vendor janë më të larta për 7.4%, krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak;
- Qarkullimi në industri në muajin shkurt të vitit 2025, krahasuar me muajin shkurt të vitit 2024 shënoi rënie për 1.1%;
- Norma e inflacionit në muajin shkurt të vitit 2025 është 5.0% në nivel vjetor, me ç'rast këtë muaj ajo regjistroi përshejtim të rritjes (4.9% në muajin janar të vitit 2025). Në nivel mujor, inflacioni u rrit për 0.5%;
- Në periudhën janar - shkurt të vitit 2025, eksporti shënoi rritje prej 1.8%, ndërsa importi prej 5.1%, që rezultoi në rritje të deficitit tregtar për 12.6% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024;
- Në periudhën janar - shkurt të vitit 2025, realizimi i të ardhurave të përgjithshme buxhetore të Buxhetit të RMV-së ishte në 47.538 milionë denarë, që paraqet 13.3% të vlerës së planifikuar për vitin 2025, përkatësisht rritje prej 6.5%, krahasuar me të ardhurat e realizuara buxhetore, në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2024;
- Realizimi i shpenzimeve të përgjithshme në periudhën janar - shkurt të vitit 2025 ishte 54.852 milionë denarë, që paraqet 13.7% të planit vjetor dhe shënon ulje prej 1.8% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024;
- Në muajin shkurt të vitit 2025, kreditë e përgjithshme të bankave shënuan rritje për 11.5%, krahasuar me muajin shkurt të vitit 2024, ndërsa potenciali i përgjithshëm i depozitave të bankave ka shënuar rritje prej 11.1%.



1. SEKTORI REAL

Prodhim industrial

Në muajin shkurt të vitit 2025, prodhimi industrial ka shënuar rënie prej 0.8% krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak. Rënia rezulton për shkak të prodhimit të reduktuar të sektorëve të minierave dhe gurorëve për 4.4% dhe furnizimit me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar për 7.7%, ndërsa sektori i industrisë së përpunimit për 1.7%.


Rritje të prodhimit në muajin shkurt të vitit 2025 shënojnë 14 prej gjithsej 27 degëve industriale, të cilat përbëjnë 36.1% të industrisë së përgjithshme.

Nga degët me vlerë të shtuar më të lartë, në muajin shkurt të vitit 2025, rritje ka shënuar prodhimi i metaleve për 19.4% me kontribut prej 0.6 p.p. dhe prodhimi i pajisjeve elektrike për 0.3% me kontribut prej 0.0 p.p., ndërsa rënie shënuan dega e prodhimit të makinerive dhe pajisjeve për 14.2% me kontribut prej -0.8 p.p. dhe dega e prodhimit të automjeteve, rimorkiove dhe gjysmë-rimorkiove për 11.0% me kontribut prej -1.9 p.p..

Nga degët tradicionale, në muajin shkurt të vitit 2025, rritje prodhimi kishin degët e mëposhtme: prodhimi i produkteve të duhanit për 238.7% me kontribut prej 2.5 p.p., prodhimi i lëkurës për 4.8% me kontribut prej 0.0 p.p., përpunimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe tapave për 142.8% me kontribut prej 1.2 p.p. dhe prodhimi i veshjeve për 5.2% me kontribut prej 0.3 p.p., ndërsa rënie të prodhimit vërehet në degët e mëposhtme: prodhimi i pijeve për 0.1% me kontribut prej 0.0 p.p., prodhimi i tekstilit për 12.4% me kontribut prej -0.6 p.p. dhe industria ushqimore për 1.7%, me kontribut prej -0.2 p.p..


Në vitin 2025, krahasuar me muajin e njëjtë të vitit të kaluar, prodhimi industrial sipas destinimit të njësisë prodhuese shënoi rënie te grupet: energjia (me rënie prej 8.3% dhe kontribut prej -0.7 p.p.) dhe prodhimet kapitale (me rënie prej 12.1% dhe kontribut prej -3.1 p.p.), ndërsa prodhimi shënoi rritje në grupet: produktet intermediare, përveç energjisë (me rritje prej 11.7% dhe kontribut prej 3.5 p.p.), produktet me afat të gjatë skadence për konsum të gjerë (me rritje prej 13.2% dhe kontribut prej 0.6 p.p.) dhe produktet me afat të shkurtër skadence për konsum të gjerë (me rritje prej 1.9% dhe kontribut prej 0.6 p.p.).

Grafiku 1.1: Prodhimi industrial
(shkallët e rritjes në %)



Burimi: ESHS


Grafiku 1.2: Struktura e rritjes së industrisë
(kontributi në p.p.)



Burimi: ESHS




Grafiku 1.3a: Degët me kontributin pozitiv të rritjes
(normat e rritjes në %, shkurt 2025)



Burimi: ESHS

Grafiku 1.3b: Degët me kontributin negativ të rritjes
(normat e rritjes në %, shkurt 2025)



Burimi: ESHS

Sipas qëllimit të njësisë prodhuese, rritje në periudhën janar - shkurt të vitit 2025 u regjistrua në grupet vijuese: produkte intermediare, përveç energjisë (për 13.8%), produktet me afat të gjatë skadence për konsum të gjerë (për 16.4%) dhe produktet me afat të shkurtër skadence për konsum të gjerë (për 2.1%), ndërsa rënie u regjistrua në grupet: Energjia (për 8.4%) dhe produktet kapitale (për 10.4%).

Numri i të punësuarve në industri

Në muajin shkurt të vitit 2025, numri i të punësuarve në industri u ul për 4.1% krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak. Rënia rezultoi për shkak të numrit të zvogëluar të të punësuarve në të gjithë sektorët: minierat dhe guroret për 2.3% industria e përpunimit për 4.3% dhe furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar për 1.5%. Rritje e numrit të të punësuarve vërehet në këto degë: prodhimi i makinerive dhe pajisjeve, të paspecifikuara diku tjetër për 30.8% prodhimi i produkteve farmaceutike bazë dhe preparateve farmaceutike për 7.9% dhe prodhimi i pijeve për 3.7%.

Të dhënat për numrin e të punësuarve në industri sipas grupeve të destinimit në muajin shkurt të vitit 2025, krahasuar me muajin e njëjtë të vitit të kaluar, tregojnë se rritje të numrit të të punësuarve shënon vetëm grupi i produkteve me afat të gjatë skadence për konsum të gjerë për 18.0%.


Të dhënat kumulative tregojnë se numri i të punësuarve në industri në periudhën janar - shkurt të vitit 2025 është ulur për 3.8%, që është për shkak të numrit të zvogëluar të të punësuarve në të gjithë sektorët: miniera dhe gurore për 2.0%, industria e përpunimit për 4.0% dhe furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar për 1.5%.

Sa i përket grupeve të destinuara, numri i të punësuarve në industri në periudhën janar - shkurt të vitit 2025 është rritur vetëm në sektorin e produkteve me afat të gjatë skadence për konsum të gjerë për 20.1%.




Çmimet e shitjes së prodhuesve të produkteve industriale në tregun vendor

Në muajin shkurt të vitit 2025, çmimet e shitjes së prodhuesve të produkteve industriale në tregun vendor ishin për 7.4% më të larta, krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak. Rritja vjen si pasojë e rritjes së çmimeve në këto sektorë: industria e përpunimit për 4.4%, furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar për 26.0% dhe furnizimi me ujë; trajtimi i ujërave të zeza, menaxhimi i mbeturinave dhe aktivitetet e përmirësimit të mjedisit për 4.8%, çmimet e shitjes në sektorin e minierave dhe guroreve u ulën për 1.1%.



Në muajin shkurt të vitit 2025, krahasuar me muajin shkurt të vitit 2024, çmimet e shitjes së prodhuesve të produkteve industriale në tregun vendor janë më të larta në këto grupe: energjia për 23.5%, produktet intermediare, përveç energjisë 2.7% produktet e konsumit të gjërë për 5.6%, dhe produktet me afat të shkurtër skadence për 6.0%.



Në bazë kumulative, në periudhën janar - shkurt të vitit 2025, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, çmimet e shitjes së prodhuesve të produkteve industriale në tregun vendor ishin më të larta për 6.7%, për shkak të rritjes së çmimeve në këto sektorë: industria e përpunimit për 4.3%, furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar për 21.6% dhe furnizimi me ujë; trajtimi i ujërave të zeza, menaxhimi i mbeturinave dhe aktivitetet e përmirësimit të mjedisit për 4.8%, ndërsa rënie të çmimeve të shitjes pati sektori i minierave dhe guroreve për 1.1%.

Në periudhën janar - shkurt të vitit 2025, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, çmimet e shitjes së prodhuesve të produkteve industriale në tregun vendor ishin më të larta në këto grupe: energjia për 19.6%, produkte intermediare, përveç energjisë për 2.2%, mallrat për konsum të gjërë për 5.9% dhe produktet me afat të shkurtër skadence për 6.2%.



Indeksi i qarkullimit në industri

Sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikave, qarkullimi në industri në muajin shkurt të vitit 2025, në raport me muajin shkurt të vitit 2024 shënoi ulje për 1.1%. Rënia është për shkak të uljes së qarkullimit në sektorin e industrisë së përpunimit për 1.3%, ndërsa sektori i minierave dhe gurorëve shënoi rritje për 4.9%.


Në muajin shkurt të vitit 2025, krahasuar me muajin e njëjtë të vitit të kaluar, qarkullimi në industri ishte rritur vetëm në grupin e produkteve intermediare, përveç energjisë për 4.4%, ndërsa rënie kishte në grupin e produkteve kapitale për 4.2%, produkteve me afat të gjatë skadence për konsum të gjerë për 2.7%, ndërsa në grupin e produkteve me afat të shkurtër skadence për konsum të gjerë kishte rritje për 0.9%.

Degët me rritjen më të lartë të qarkullimit në industri në muajin shkurt të vitit 2025, krahasuar me muajin e njëjtë të vitit të kaluar janë:

- Prodhimi i produkteve të duhanit (rritje prej 75.5%);
- Prodhimi i pajisjeve të tjera të transportit (rritje prej 62.4%) dhe
- Prodhimi i lëkurës dhe produkteve të ngjashme prej lëkure (rritje prej 50.4%).


Në bazë kumulative, në periudhën janar - shkurt të vitit 2025, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, qarkullimi në industri u rrit për 3.5%, që është si rezultati i rritjes së qarkullimit në këto dy sektorë - minierat dhe gurorët për 21.1% dhe industria e përpunimit për 3.0%.

Në periudhën janar - shkurt të vitit 2025, krahasuar me periudhën janar – shkurt të vitit 2024, qarkullimi në industri shënoi rritje në këto grupe: produktet intermediare, përveç energjisë për 8.5%, produktet me afat të gjatë skadence për konsum të gjerë për 5.3% dhe produktet kapitale për 2.7%.



Numri i lejeve të lëshuara të ndërtimit dhe vlera e paraparë e objekteve

Në muajin shkurt të vitit 2025 janë lëshuar gjithsej 272 leje ndërtimi, që paraqet rënie prej 29.7%, krahasuar me muajin e njëjtë të vitit 2024. Kjo rezulton për shkak të rënies vjetore të lejeve të lëshuara për objekte të ndërtimeve të larta për 19.9% (të cilat paraqesin 50.4% të numrit të





përgjithshëm të lejeve të lëshuara ndërtimit), ndërsa sa i përket rikonstruimit të objekteve për 36.1%. Krahasuar me muajin janar të vitit 2025, numri i lejeve të lëshuara të ndërtimit është ulur për 14.2%. Vlera e parashikuar e objekteve sipas lejeve të lëshuara të ndërtimit në muajin shkurt të vitit 2025 është më e ulët për 44.4% në bazë vjetore dhe krahasuar me muajin paraprak ka shënuar rënie për 15.1%. Analizuar sipas llojit të objekteve, nga numri i përgjithshëm i lejeve të lëshuara të ndërtimit, 137 (ose 50.4%) janë të destinuara për objektet e ndërtimeve të larta, 73 (ose 26.8%) për objektet e ndërtimeve të ulëta dhe 62 (ose 22,8%) për objekte të rikonstruimit.


Analizuar sipas llojit të investitorëve, nga gjithsej 272 lejet e lëshuara të ndërtimit, për 122 objekte (ose 44.9%) si investitorë janë personat fizikë, ndërsa për 150 objekte (ose 55.1%) si investitorë janë subjektet afariste.

Me lejet e lëshuara të ndërtimit në muajin shkurt të vitit 2025 parashikohet ndërtimi i 635 banesave me sipërfaqe të përgjithshme të shfrytëzueshme prej 51.075m². Numri i banesave të planifikuara për ndërtim është ulur për 16.3% në nivel mujor dhe për 33.2% në nivel vjetor.


Numri i punëve të kryera ndërtimore sipas llojeve të objekteve

Vlera e përgjithshme e punëve të kryera ndërtimore në muajin janar të vitit 2025 arriti në 1.762 milionë denarë, që paraqet rënie nominale vjetore prej 18.7%, me ç'rast rënie prej 12.1% u shënua në ndërtimet e larta, në ndërtimet e ulëta për 23.6%, ndërsa rritje prej 31.8% u shënua në punimet e specializuara të ndërtimit. Krahasuar me muajin dhjetor të vitit 2024, vlera e përgjithshme e punëve të kryera ndërtimore ka shënuar rënie për 72.3%, përkatësisht në ndërtimet e larta për 78.4%, në ndërtimet e ulëta për 69.2% dhe në punimet e specializuara të ndërtimit për 48.2%.


Grafiku 1.9: Struktura e lejeve të lëshuara për ndërtim sipas rajoneve (shkurt 2025)



Grafiku 1.10: Vlera e parashikuar e objekteve sipas rajoneve (në miliona denarë)



Grafiku 1.11: Punët e kryera ndërtimore (milionë denarë)





Qarkullimi në sektorin e tregtisë

Në muajin shkurt të vitit 2025, të dhënat e tregtisë së brendshme tregojnë rritje nominale vjetore të qarkullimit për 4.1%, pas rritjes prej 3.8% në muajin janar të vitit 2025. Vlera e qarkullimit në muajin shkurt të vitit 2025 është 63.306 milionë denarë, ndërsa në mënyrë kumulative, në periudhën janar-shkurt të vitit 2025, vlera e qarkullimit të përgjithshëm tregtar shënon 124.598 milionë denarë, që është për 3.9% më shumë krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak./



Në mënyrë kumulative, në periudhën janar-shkurt të vitit 2025, rritje pozitive e qarkullimit është shënuar në këto sektorë: tregtia me shumicë, vlera e qarkullimit të së cilës arriti në 67.696 milionë denarë, që është për 4.8% më shumë krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak, ndërsa te tregtia me pakicë, vlera e qarkullimit arriti në 50.197 milionë denarë, që është për 4.0% më shumë krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak, ndërsa rënie kishte në tregtinë e automjeteve dhe riparimeve, vlera e qarkullimit për atë periudhë është 6.705 milionë denarë, që është për 4.6% më pak krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak.

Në bazë reale, në muajin shkurt të vitit 2025, tregtia me pakicë shënoi rritje vjetore prej 1.2%, gjithashtu e analizuar edhe sipas grupeve dhe klasave, rritje u shënuar në këto grupe: tregtia me pakicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit për 2.6%, dhe tregtia me pakicë e karburanteve automobilistike për 1.1%, ndërsa rënie kishte grupi i tregtisë me pakicë të produkteve joushqimore për 0.8%.

Në muajin shkurt të vitit 2025, pjesëmarrje më të madhe strukturore në sektorin e tregtisë kishte njësia e tregtisë me shumicë (54.7%), e ndjekur nga tregtia me pakicë (39.1%) dhe tregtia e automjeteve dhe motoçikletave, riparimi dhe mirëmbajtja (6.2%).

Inflacioni

Norma e inflacionit në muajin shkurt të vitit 2025 ishte 5.0% në nivel vjetor dhe në këtë muaj sërish u regjistrua ngadalësim të rritjes (4.9% në muajin janar të vitit 2025). Rritja e inflacionit këtë muaj në masë të madhe rezultoi nga komponenti ushqimor që shënon rritje në muajt e fundit. Norma mesatare e inflacionit në periudhën janar-shkurt të vitit 2025 ishte 5.0%.







Në muajin shkurt të vitit 2025, inflacioni bazë (inflacioni pa ndikimin e çmimeve të produkteve ushqimore dhe energjensave) regjistroi ngadalësim në krahasim me muajin paraprak dhe shënon 5.8% në bazë vjetore (6.3% në muajin janar). Gjatë këtij muaji, kontribut më të madh pozitiv ka pasur rritja e çmimeve në kategorinë e restoranteve dhe hotelerisë (1.5 p.p.).

Në muajin shkurt të vitit 2025, çmimet në kategorinë e produkteve ushqimore dhe pijeve joalkoolike janë 6.6% dhe shënojnë ngadalësim të rritjes, në krahasim me muajin e kaluar (5.7% në muajin janar), ku kontributi i kësaj kategorie në inflacionin e përgjithshëm në muajin shkurt ishte 2.7 p.p. dhe shënon rritje për 0.4 p.p., në krahasim me muajin paraprak. Kontributi më i madh pozitiv i rritjes të kategorisë së produkteve ushqimore dhe pijeve joalkoolike kishin nënkategoritë: qumështi, djathi dhe vezët (me rritje vjetore prej 8.1% dhe kontribut prej 0.6 p.p.), mishi (me rritje vjetore prej 6.5% dhe kontribut prej 0.6 p.p.), pijet joalkoolike (me rritje vjetore prej 17.6% dhe kontribut prej 0.5 p.p.), perimet (me rritje vjetore prej 8.7% dhe kontribut prej 0.4 p.p.), kafeja, çaji, kakaoja (me rritje vjetore prej 19.2% dhe kontribut prej 0.3 p.p.) dhe duhani (me rritje vjetore prej 7.0% dhe kontribut prej 0.3 p.p.).

Sipas komponentëve, rritje më të madhe vjetore të çmimeve në muajin shkurt të vitit 2025 kishte kategoria e restoranteve dhe hoteleve prej 12.2% (me kontribut në rritjen e inflacionit të përgjithshëm prej 0.7 p.p.). Rritja e çmimeve është regjistruar edhe te këto kategori: rekreacioni dhe kultura prej 6.4%, pijet alkoolike, duhani dhe lëndët narkotike prej 5.8%¹, mallrat dhe shërbimet e ndryshme prej 4.8%, mobiliat, pajisjet elektroshtëpiake dhe mirëmbajtje e rregullt e amvisërive prej 3.9%, mbrojtja shëndetësore prej 3.8%, kategoria e veshjeve dhe këpucëve prej 3.2%, banimi, uji, elektrika, gaz dhe karburantet e tjera prej 1.7%, komunikimet prej 1.6%, transporti prej 1.0% dhe arsimi prej 0.3%.

Në muajin shkurt, çmimet e konsumit u rritën për 0.5% në nivel mujor (muajin e kaluar çmimet janë rritur për 0.2%). Rritja e çmimeve në nivel mujor para së gjithash ishte për shkak të rritjes së çmimeve të produkteve ushqimore. Në muajin shkurt, çmimet e produkteve ushqimore regjistruan rritje prej 1.4% në nivel mujor.

Në muajin shkurt të vitit 2025, çmimet e shitjes me pakicë u rritën për 4.2% në nivel vjetor dhe shënuan ngadalësimin e rritjes. Në nivel mujor, çmimet me e shitjes me pakicë regjistruan rënie prej 0.6%.



¹ Çmimi i produkteve të duhanit është rritur në përputhje me ndryshimet e miratuara në Ligjin e Akcizave, akciza për cigaret do të rritet në nivel vjetor për 0.23 denarë për copë deri në vitin 2030. Çmimi i ri i duhanit u caktua në muajin tetor 2024.






Në muajin shkurt të vitit 2025, norma e inflacionit shënoi rënie për 0.1 p.p. në Eurozonë, krahasuar me muajin dhjetor të vitit 2024 dhe paraqet 2.4%². Sipas projeksioneve të BQE-së, norma e inflacionit në periudhën afatshkurte pritet të shënojë ulje të lehtë në 2.3% në vitin 2025, përpara se të bjerë në 1.9% në vitin 2026 dhe 2.0% në vitin 2027. Një ulje e lehtë e inflacionit të përgjithshëm pritet në vitin 2025. Kjo rezulton kryesisht për shkak të inflacionit më të lartë të produkteve ushqimore dhe efekteve bazë në rritje të çmimeve të energjisë që neutralizojnë në masë të madhe ndikimin e uljes së inflacionit në rënie. Ashtu siç efektet bazë në inflacionin e energjisë zbehen, inflacioni i përgjithshëm pritet të bjerë në fillim të vitit 2026.

Çmimet e bursës

Në muajin shkurt të vitit 2025, çmimi i naftës së papërpunuar (Brent) në bursat botërore ka shënuar ulje për 5.1% në nivel mujor dhe shënon 75.2 dollarë për fuçi. Ulja ishte për shkak të disa faktorëve, si rritja e ofertës së naftës nga vendet që nuk janë pjesë e OPEC+ dhe vendosja e tarifave që rritën shqetësimin rreth rritjes ekonomike globale, që mund ta ulë kërkesën e naftës. Në nivel vjetor, çmimi i naftës është më i ulët për 10.3%.

Në muajin shkurt të vitit 2025, çmimi i gazit natyror është rritur për 3.5% në nivel mujor. Çmimi i gazit ishte nën ndikimin e disa faktorëve, duke përfshirë këtu tensionet gjeopolitike për shkak të cilave Rusia ka ndërprerë furnizimin me gaz drejt Europës përmes Ukrainës, kushteve të motit, si dhe uljes së rezervave të gazit për shkak të uljes së prodhimit të gazit nga burimet e energjisë së ripërtëritshme. Këta faktorë, si dhe presionet ende të pranishme të inflacionit, kanë rriur shqetësimin në tregun e gazit, që shkaktoi jostabilitet më të madh. Këtë muaj, çmimi i gazit natyror u rrit për 92.9% në nivel vjetor.

² Të dhënat janë vlerësim i Eurostat-it.





Sipas Bursës Hungareze të Energjisë Elektrike (HUPX), Çmimi i energjisë elektrike në muajin shkurt të vitit 2025 ishte 158.88 euro për megvat/orë, ku në nivel mujor u regjistrua rritje prej 13.3%. Çmimet e energjisë elektrike regjistruan rritje, si rezultat i rritjes së çmimit të gazit natyror dhe rritjes së kërkesës. Këtë muaj, çmimi i energjisë elektrike shënoi rritje për 129.1% në nivel vjetor

Në muajin shkurt të vitit 2025, çmimet e shumicës së metaleve bazë kanë regjistruar rritje në nivel mujor, respektivisht plumbi për 1.8%, alumini për 3.3%, bakri për 3.8% dhe kallaji për 7.5%. Çmimet e nikelit dhe zinkut janë ulur për 0.7%. Çmimi i xehes së hekurit u rrit për 5.5% në nivel mujor.

Në muajin shkurt të vitit 2025, çmimet e metaleve të çmuara regjistruan rritje në bazë mujore, me ç'rast çmimi u rrit për 6.8%, argjendit për 5.7% dhe platinin për 3.1%.

Në muajin shkurt, çmimet e grurit dhe misrit u rritën në bazë mujore, respektivisht për 3.0% dhe 5.6%. Çmimi i vajit të lulediellit u rrit për 1.1% në bazë mujore.

Tabela 1.1. Çmimet e energjensave në bursa (të dhëna mujore)

	Electricity (EUR/MWh) Energjia elektrike	Crude Oil, Brent (\$/bbl) Nafta bruto, Brent	Natural GAS, Europe (\$/1000 m3) Gazi natyror, Evropë
2023 I	148,7	83,1	714,1
II	146,2	82,7	585,1
III	113,4	78,5	488,7
IV	106,7	84,1	478,4
V	88,2	75,7	357,7
VI	96,6	74,9	366,2
VII	94,5	80,1	337,2
VIII	100,4	86,2	396
IX	103,8	94,0	408,6
X	104,9	91,1	515,5
XI	99,38	83,2	512,5
XII	81,72	77,9	407,1
2024 I	85,73	80,2	338,2
II	69,35	83,8	288,3
III	65,12	85,5	302,6
IV	61,96	90,5	321,4
V	72,2	82,0	358,2
VI	91,7	82,6	384,6
VII	135,5	85,3	366,1
VIII	120,8	80,9	437,8
IX	106,1	74,3	416,94
X	92,2	75,7	457,1
XI	163,7	74,4	492,7
XII	143,9	73,8	490,3
2025 I	140,2	79,2	518,8
II	158,9	75,2	542,8

Burimi: Banka Botërore, Bursa Hungareze e energjisë elektrike (World Bank, Hungarian Power Exchange)



2. SHKËMBIMI I JASHTËM TREGTAR

Shkëmbimi i përgjithshëm i jashtëm tregtar në dy muajt e parë të vitit 2025 shënon 3.063.6 milionë euro dhe shënon rritje prej 3.8%, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Në periudhën janar – shkurt të vitit 2025, pjesëmarrja e shkëmbimit me Bashkimin Evropian (BE 27), si partner më i madh tregtar shënoi ulje për 3.5 p.p., në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar dhe shënon 59.8%. Gjermania është partnerja më e rëndësishme tregtare e vendit tonë. Në strukturën e shkëmbimit të përgjithshëm të jashtëm tregtar të vendit tonë, pjesëmarrja e shkëmbimit tregtar me Gjermani në dy muajt e parë të vitit 2025 shënon 20.8% dhe është ulur për 2.8 p.p., në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2024.

Eksporti


Vlera e mallrave të eksportuara në dy muajt e parë të vitit 2025 ishte 1.229.4 milionë euro dhe shënon rritje prej 1.8% (21.5 milionë euro) në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2024, ndërsa vëllimi fizik i eksportit është rritur për 1.8% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Vlera e mallrave të eksportuara në muajin shkurt të vitit 2025 ishte 650.5 milionë euro dhe shënon rënie prej 1.0% (6.7 milionë euro) në krahasim me muajin e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa vëllimi fizik i eksportit shënon ulje për 1.8%, në krahasim me muajin shkurt të vitit 2024.

Dule analizuar në nivel mujor, në muajin shkurt të vitit 2025, eksporti shënoi rritje prej 12.4% (71.7 milionë euro) në krahasim me muajin e kaluar, ndërsa nëse bëhet rregullim sezonal i eksportit, ai ka regjistruar rënie mujore prej 3.6%, që tregon ndikim pozitiv të faktorit sezonal 16.0 p.p.) mbi eksportin këtë muaj.


Vlera e importit të produkteve ushqimore në dy muaj të parë të vitit 2025 është rritur për 6.7 milionë euro, që paraqet rritje prej 10.4% në krahasim

Grafiku 2.1: Tregtia e jashtme
(vlerat në milionë euro)




Burimi: ESHS

Grafiku 2.2: Shkëmbimi i jashtëm tregtar me Gjermaninë dhe BE 27
(vlerat në milionë euro)



Burimi: ESHS

Grafiku 2.3: Produktet me pjesëmarrje më të larë në eksport
(sipas KSNT-së)



Burimi: ESHS



me periudhën e njëjtë të vitit 2024, ndërsa sasia e ushqimit të eksportuar është rritur për 5.3%. Në strukturën e eksportit të përgjithshëm të vendit tonë, pjesëmarrja e ushqimit është 5.8% dhe është rritur për 0.5 p.p., në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2024. Në eksportin e përgjithshëm të produkteve ushqimore, pjesëmarrje më të madhe kishte eksporti i produkteve në vijim: frutat dhe perimet (39.0%), drithërat dhe përpunimi i drithërave (27.6%) kafeja, çaji, kakoja dhe erëzat (9.3%) dhe produktet e qumështit dhe vezët (7.4%).


Duke analizuar sipas grupeve ekonomike³ të vendeve, në periudhën janar – shkurt të vitit 2025, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024, eksporti shënon rritje në këto grupe: EFTA, Ballkani Perëndimor, Zona e Tregtisë së Lirë të Amerikës së Veriut dhe Bashkësia e Shteteve të Pavarura, ndërsa rënie kishte në këto grupe: BE 27, Organizata e Vendeve Eksportuese të Naftës dhe Derivateve të Naftës dhe Organizata e Bashkëpunimit Ekonomik të Vendeve nga Rajoni i Azisë – Paqësorit. Eksporti në BE 27 shënon rënie prej 0.9% në nivel vjetor dhe përfshin 77.7% në eksportin e përgjithshëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa eksporti në vendet e Ballkanit Perëndimor shënon rritje prej 1.1% dhe përfshin 12.3% të eksportit të përgjithshëm të vendit tonë.

Importi

Vlera e mallrave të importuara në dy muajt e parë të vitit 2025 shënon 1.834.2 milionë euro dhe shënon rritje prej 5.1% (89.3 milionë euro) në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2024, ndërsa vëllimi fizik i importit shënon rritje prej 16.0%.


Vlera e importit në muajin shkurt 2025 arriti në 984.9 milionë euro, me ç'rast u shënuar rritje prej 4.3% (40.6 milionë euro), krahasuar me muajin e njëjtë të vitit 2024, ndërsa sasitë e importuara të mallrave u rritën për 13.7%, krahasuar me muajin shkurt të vitit 2024.

Grafiku 2.4: Struktura e eksportit sipas destinimit ekonomik (pjesëmarrja në %)



Burimi: ESHS; përllogaritjet e MF-së

Grafiku 2.5: Struktura e importit sipas destinimit ekonomik (pjesëmarrja në %)



Burimi: ESHS; përllogaritjet e MF-së

Analizuar në nivel mujor, në muajin shkurt 2025, importi shënoi rritje prej 16.0% (135.7 milionë euro), krahasuar me muajin paraprak, ndërsa nëse bëhet përshtatja sezonale e importit, ai regjistroi

³ Grupet ekonomike përfshijnë vendet në vijim: BE 27 (Austria, Belgjika, Bullgaria, Kroacia, Qiproja, Republika Çeke, Gjermania, Danimarka, Estonia, Spanja, Finlanda, Franca, Greqia, Hungaria, Irlanda, Italia, Lituania, Luksemburgu, Letonia, Malta, Holanda, Polonia, Portugalia, Rumania, Suedia, Sllovenia dhe Sllovakia); EFTA (Zvicra, Islanda, Lihtenshtajni dhe Norvegjia); Organizata e Vendeve Eksportuese të Naftës dhe Derivateve të Naftës (Emiratet e Bashkuara Arabe, Angola, Algjeria, Ekuadori, Iraku, Irani, Kuvajti, Libia, Nigeria, Katari, Arabia Saudite dhe Venezuela); Ballkani Perëndimor (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Kosova dhe Serbia); Zona e Tregtisë së Lirë e Amerikës së Veriut (Kanadaja, Meksika dhe SHBA-ja); Organizata e Bashkëpunimit Ekonomik e Rajonit të Azisë-Paqësorit (Australia, Brunei, Kanadaja, Kili, Kina, Hong Kongu, Indonezia, Japonia, Koreja, Meksika, Malajzia, Zelanda e Re, Peruja, Papua Guinea e Re, Filipinet, Rusia, Singapori, Tajlanda, Tajvani, SHBA-ja dhe Vietnamit) dhe Bashkësia e Shteteve të Pavarura (Armenia, Azerbajxhani, Bjellorusia, Kirgistani, Kazakistani, Moldavia, Rusia, Taxhikistani, Turkmenistani, Ukraina dhe Uzbekistani).



rritje mujore prej 1.5%, që tregon ndikimin pozitiv të faktorit sezonal (14.5 p.p.) ndaj importit gjatë këtij muaji.

Vlera e importit të produkteve ushqimore në dy muajt e parë të vitit 2025, shënon rritje për 11.1 milionë euro, që paraqet rritje prej 6.6%, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2024, ndërsa sasia e ushqimit të importit shënon rritje për 2.1%. Në strukturën e importit të përgjithshëm të vendit tonë, në dy muajt e parë të vitit 2025, pjesëmarrja e produkteve ushqimore shënon 9.7% dhe është rritur për 0.1 p.p., në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2024. Në importin e përgjithshëm të produkteve ushqimore, pjesëmarrje më të madhe ka importi i produkteve në vijim: mishi dhe përpunimi i mishit (21.4%), frutat dhe perimet (16.8%), drithërat dhe përpudhimi i drithërave (13.0%), kafeja, çaji, kakaoja dhe erëzat (11.9%) dhe produktet e qumështit dhe vezët (10.3%).

Tabela 2.1. Pasqyra e eksportit dhe importit të grupeve të përzgjedhura të produkteve

Eksporti i naftës dhe produkteve të naftës*)					Importi i naftës dhe produkteve të naftës*)				
	I - II 2024	I - II 2025	Saldo	Normat në %		I - II 2024	I - II 2025	Saldo	Normat në %
.000 T	13,6	12,4	-1,2	-8,7	.000 T	175,2	161,7	-13,5	-7,7
Mil. EURO	11,6	9,5	-2,1	-18,1	Mil. EURO	134,0	117,6	-16,4	-12,2
Mil.\$	12,5	9,8	-2,7	-21,7	Mil.\$	145,4	122,0	-23,5	-16,1

*)Të dhënat paraprake

Eksporti i produkteve kimike*)					Importi i produkteve kimike*)				
	I - II 2024	I - II 2025	Saldo	Normat në %		I - II 2024	I - II 2025	Saldo	Normat në %
.000 T	3,3	8,7	5,4	162,6	.000 T	4,8	4,9	0,1	1,0
Mil. EURO	290,3	273,6	-16,7	-5,8	Mil. EURO	27,9	28,4	0,5	1,8
Mil.\$	314,7	284,3	-30,4	-9,7	Mil.\$	30,3	29,5	-0,7	-2,4

*)Të dhënat paraprake

Eksporti i hekurit dhe çelikut*)					Importi i hekurit dhe çelikut*)				
	I - II 2024	I - II 2025	Saldo	Normat në %		I - II 2024	I - II 2025	Saldo	Normat në %
.000 T	124,7	122,9	-1,8	-1,5	.000 T	96,2	132,6	36,4	37,8
Mil. EURO	98,2	90,2	-8,0	-8,1	Mil. EURO	67,6	83,8	16,2	24,0
Mil.\$	106,5	93,6	-12,9	-12,1	Mil.\$	73,3	87,0	13,7	18,7


*)Të dhënat paraprake

Saldoja e shkëmbimit tregtar

Në muajin shkurt të vitit 2025, deficitin tregtar u rrit për 16.5%, përkatësisht 47.3 milionë euro, në krahasim me muajin shkurt të vitit 2024.

Në periudhën janar – shkurt të vitit 2025, deficitin tregtar u rrit për 12.6%, përkatësisht 67.8 milionë euro, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Nëse saldon e eksportit dhe importit të mallrave e analizojmë sipas destinimit





ekonomik, rritja e deficitit ishte për shkak të rritjes së deficitit gjatë shkëmbimit të prokurimeve industriale, karburanteve dhe vajrave, mallrave për konsum të gjerë, produkteve të ushqimit dhe pijeve. Megjithatë, nga ana tjetër, në uljen e saldove negative ndikim ka pasur ulja e deficitit në shkëmbimin e mallrave për investime pa pajisje transporti, si dhe rritja e saldove pozitive gjatë shkëmbimit me pajisje transporti.

Në dy muajt e parë të vitit 2025, 90.0% e deficitit tregtar të vendit u realizua gjatë shkëmbimit me Britaninë e Madhe, Kinën dhe Greqinë, pastaj vijojnë me Turqinë, Serbinë, Poloninë, Bullgarinë, Rusinë etj.. Suficiti u realizua gjatë shkëmbimit me Gjermaninë, Kosovën, Çekinë, Sllovakinë, Hungarinë etj.

Struktura valutore

Sipas aspektit të strukturës valutore, 91.1% e shkëmbimit tregtar gjatë periudhës janar-shkurt të vitit 2025 u realizua në euro, që në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2024 paraqet ulje për 1.8 p.p. Sa i përket eksportit dhe importit, euroja është e pranishme me 92.4% dhe 90.2%, respektivisht, përfshirja e euros te eksporti ka shënuar ulje për 3.5 p.p., ndërsa te importi për 0.7 p.p., në krahasim me periudhën janar-shkurt të vitit 2024.

Tabela 2.2 Shkëmbimi tregtar i Republikës së Maqedonisë së Veriut (sipas valutave); përlogaritjet e MF-së												
Importi	I - II - 2024					I - II - 2025					ndryshim absolut në vlerën e valutës	ndryshimi relativ në vlerën e valutës (në %)
valuta	sasia. 000 t	importi në valutë	kursi mesatar i denarit kundrejt valutave	importi në denarë	strukt. në%	sasia. 000 t	importi në denarë	kursi mesatar i denarit kundrejt valutave	importi në denarë	strukt. në%		
EYP	910,7	1.586.545.274	61,6493	97.809.405.574	90,9	1.063,2	1.654.888.387	61,5284	101.822.634.643	90,2	68.343.113	4,3
USD	80,2	152.670.053	56,7728	8.667.506.403	8,1	86,7	170.071.352	59,2858	10.082.816.181	8,9	17.401.299	11,4
GBP	0,6	5.092.035	71,9372	366.306.705	0,3	0,3	3.005.921	73,6740	221.458.254	0,2	-2.086.113	-41,0
EURO+USD+GPB	991,4			106.843.218.682	99,0	1.150,2			112.126.909.079	99,3		
vk eksporti	994,2			107.589.010.633	100,0	1.153,7			112.862.258.194	100,0		4,9

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave dhe BPRMV-ia

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave dhe BPRMV-ja

3. SEKTORI FISKAL

Të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore sipas klasifikimit ekonomik

Në periudhën janar – shkurt të vitit 2025, realizimi i të ardhurave të përgjithshme buxhetore të Buxhetit të RMV-së shënon 47.538 milionë denarë, që paraqet 13.3% e vlerës së planifikuar për vitin 2025, përkatësisht rritje për 6.5%, në raport me të ardhurat e realizuara buxhetore, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024. Në kuadër të të ardhurave të përgjithshme, 43.866 milionë denarë janë realizuar në bazë të të ardhurave tatimore dhe kontributeve sociale, me ç'rast shkalla e realizimit ishte 13.7% e vlerës së planifikimit për vitin 2025, përkatësisht u konstatua rritje prej 8.0% në krahasim me vitin e kaluar. Gjithashtu, realizimi i të ardhurave tatimore e arriti vlerën prej 26.580 milionë denarëve (realizim prej 13.4% të vlerës së planifikuar për vitin 2025), ndërsa ai i kontributeve prej 17.050 milionë denarëve (me rritje vjetore prej 9.7%, përkatësisht 14.6% e vlerës së planifikuar për vitin 2025). Në kuadër të të ardhurave tatimore konstatohet rritje e të ardhurave në bazë të: tatimit të të ardhurave personale për 0.5%, tatimit mbi fitimin për 6.9%, tatimit mbi vlerën e shtuar për 9.4%, akcizave për 4.6% dhe detyrimeve të importit për 18.2%, ndërsa të ardhurat e tjera tatimore shënuan ulje për 34.9%. Në këtë periudhë, të ardhurat jotatimore shënuan ulje për 13.5%, të ardhurat kapitale shënuan ulje për 20.0%, ndërsa të ardhurat në bazë të donacioneve nga jashtë shënuan rritje për 47.7%.

Realizimi i shpenzimeve të përgjithshme gjatë periudhës janar – shkurt të vitit 2025 ishte në vlerë prej 54.852 milionë denarëve, që paraqet 13.7% e planit vjetor dhe shënon ulje prej 1.8% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2024. Gjithashtu, realizimi i shpenzimeve rrjedhëse ishte 51.966 milionë



denarë ose 14.7% e vlerës së planifikuar për tërë vitin, që paraqet rritje prej 3.2% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2024. Rritje konstatohet edhe te shpenzimet e rrogave dhe kompensimeve për 10.2% dhe te shpenzimet në bazë të interesit për 29.9%. Shpenzimet për mallra dhe shërbime janë ulur për 7.0%. Transfertat, që paraqesin kategorinë më të madhe të shpenzimeve rrjedhëse, janë rritur për 0.8% për shkak të rritjes së transfertave sociale për 5.0%, shpenzimet për mbrojtjen shëndetësore për 3.6%, dotacionet bllok dhe ato të destinuara për 7.0%. Gjatë kësaj periudhe, shpenzimet për subvencione dhe transfertat u zvogëluan për 27.2%. Realizimi i shpenzimeve kapitale shënon 2.886 milionë denarë dhe ato janë më të ulëta për 47.2% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2024. Shkalla e realizimit të shpenzimeve kapitale gjatë periudhës janar – shkurt të vitit 2025, në krahasim me vlerën e planifikuar ishte 6.1%.

Tabela 3.1. Realizimi i Buxhetit të RMV-së në periudhën janar – shkurt të vitit 2025


	Buxheti 2025	janar – shkurt 2025		
	miliona denarë	miliona denarë	norma vjetore e rritjes (në %)	norma e realizimit
TË ARDHURA TË PËRGJITHSHME	358.838	47.538	6,5%	13,2%
Tatimet dhe kontribute	319.234	43.866	8,0%	13,7%
Tatime	198.607	26.580	6,9%	13,4%
Tatimi mbi të ardhurat personale	35.676	4.766	0,5%	13,4%
Tatimi mbi fitimin	23.287	2.523	6,9%	10,8%
TVSH	86.692	12.343	9,4%	14,2%
Akciza	35.388	4.573	4,6%	12,9%
Detyrime të importit	16.255	2.239	18,2%	13,8%
Të ardhura të tjera tatimore	1.309	136	-34,9%	10,4%
Kontribute	117.095	17.050	9,7%	14,6%
Të ardhura jotatimore	26.302	3.078	-13,5%	11,7%
Të ardhura kapitale	3.510	136	-20,0%	3,9%
Donacionet të jashtme	9.792	458	47,7%	4,7%
Të ardhura nga huatë e arkëtuara	0	0		
SHPENZIME TË PËRGJITHSHME	400.188	54.852	-1,8%	13,7%
Shpenzime rrjedhëse	353.032	51.966	3,2%	14,7%
Paga dhe kompensime	48.141	7.459	10,2%	15,5%
Mallra dhe shërbime	26.325	2.869	-7,0%	10,9%
Transferta	257.721	38.027	0,8%	14,8%
Transferta sociale	191.046	29.008	5,0%	15,2%



SPIMV	119.995	18.819	6,1%	15,7%
Kompensimi financiar për personat e papunësuar	3.439	254	-0,4%	7,4%
Ndihmë sociale	15.080	2.435	2,0%	16,1%
Mbrojtje sociale	52.531	7.500	3,6%	14,3%
Transferta të tjera	64.211	8.751	-10,5%	13,6%
Interesi	20.845	3.611	29,9%	17,3%
Shpenzime kapitale	47.156	2.886	-47,2%	6,1%
SALDOJ BUXHETORE	-41.350	-7.314	-34,7%	17,7%


Burimi: Ministria e Financave

Grafiku 3.1. Struktura e të hyrave të tjera tatimore të realizuara, shkurt 2025




Burimi: Ministria e Financave

Grafiku 3.2. Struktura e shpenzimeve të realizuara sipas klasifikimit ekonomik, janar- shkurt 2025



Burimi: Ministria e Financave

Grafiku 3.3. Deficiti buxhetor, të dhënat kumulative (mil. denarë)



Deficiti i Buxhetit të RMV-së, në periudhën janar – shkurt të vitit 2025 u realizua prej 7.314 milionë denarëve, që paraqet 0.7% e PBB-së së projektuar për vitin 2025, përkatësisht 17.7% e planit vjetor.




Shpenzimet sipas shfrytëzuesve buxhetorë

Në vazhdim jepet pasqyra e shpenzimeve buxhetore për shfrytëzuesit më të mëdhenj buxhetorë.

Gjatë periudhës janar – shkurt të vitit 2025, Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë ka realizuar 15.753 milionë denarë ose 23.0% e buxhetit të përgjithshëm për vitin aktual. Gjithashtu, pjesa më e madhe (78.6%) e shpenzimeve u destinuan për transferta rrjedhëse në fondet jashtëbuxhetore, me ç'rast u shpenzuan 12.384 milionë denarë ose 25.8% e mjeteve të destinuara për vitin 2025. Zëri i dytë më i rëndësishëm i shpenzimeve janë përfitimet sociale, me përfshirje prej 15.2% e shpenzimeve të përgjithshme dhe për këtë destinim janë realizuar 16.9% (2.401 milionë denarë) nga planifikimi për vitin 2025.

Gjatë periudhës së analizuar, Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka realizuar mjete buxhetore në vlerë prej 6.710 milionë denarëve, që është 15.5% e buxhetit të përgjithshëm për vitin 2025. Pjesa më e madhe e shpenzimeve (56.7%) paraqet transferta rrjedhëse në NJVL, ku janë shpenzuar 3.805 milionë denarë ose 15.9% e mjeteve të përgjithshme të planifikuara. Pagat dhe kompensimet janë zëri i dytë më i rëndësishëm me pjesëmarrje prej 21.6%, ku janë shpenzuar 1.448 milionë denarë, përkatësisht 15.5% e mjeteve të përgjithshme të planifikuara.

Grafiku 3.4: Struktura e shpenzimeve sipas shfrytëzuesve buxhetorë dhe ndarjeve (janar-shkurt 2025)



Gjatë periudhës janar – shkurt të vitit 2025, Ministria e Punëve të Brendshme ka realizuar gjithsej 2.068 milionë denarë, që paraqet 12.9% e buxhetit vetanak për vitin 2025. Zëri më i rëndësishëm i shpenzimeve ishin pagat dhe kompensimet prej 77.5%, ku u shpenzuan 1.603 milionë denarë ose 16.2% e planifikimit. Zëri i dytë më i rëndësishëm ishin mallrat dhe shërbimet, me përfshirje prej 17.1%. Për këtë destinim u shpenzuan 353 milionë denarë ose 11.1% e planit vjetor.

Në këtë periudhë, Agjencia e Përkrahjes Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural (APFBZHR) ka realizuar 578 milionë denarë, që paraqet 7.1% të mjeteve të planifikuara për vitin aktual. Subvencionet dhe transfertat të cilat kanë pjesëmarrje më të lartë prej 93.1% në shpenzimet e përgjithshme, u realizuan 7.6% nga mjetet e planifikuara për tërë vitin, përkatësisht 538 milionë denarë.

Në periudhën janar - shkurt të vitit 2025, Ministria e Mbrojtjes realizoi 3.619 milionë denarë, që është 17.7% e buxhetit të përgjithshëm për këtë vit. Shpenzimet kapitale kishin pjesëmarrjen më të madhe në shpenzime me 47.4%, ku për këtë qëllim, realizimi arrin në 1.717 milionë denarë (20.2% nga mjetet e përgjithshme të parapara për vitin aktual). Pagat dhe kompensimet kishin pjesëmarrje me 29.0% në shpenzimet të përgjithshme dhe për këtë zë u shpenzuan 1.051 milionë denarë, përkatësisht 15.5% nga parashikimi i përgjithshëm.

Në periudhën janar - shkurt të vitit 2025, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut realizoi gjithsej 747 milionë denarë, përkatësisht 10.9% të mjeteve të planifikuara për vitin 2025. Për më tepër, subvencionet dhe transfertat paraqesin 58.5% të shpenzimeve të përgjithshme të këtij shfrytëzuesi buxhetor, ndërsa u realizuan në vlerë prej 438 milionë denarësh (8.4% të mjeteve të parashikuara).



Në periudhën e analizuar, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave ka realizuar mjete në vlerë prej 224 milionë denarë ose 2.9% të buxhetit të përgjithshëm për vitin 2025. Mallrat dhe shërbimet kanë pjesëmarrjen më të madhe në shpenzime me 64.2%, për të cilat u shpenzuan 144 milionë denarë ose 4.1% të mjeteve të parapara për vitin 2025. Zëri i dytë më i rëndësishëm janë shpenzimet kapitale me realizim prej 46 milionë denarëve (8.4% nga planifikimi për vitin në fjalë) dhe me pjesëmarrje prej 20.4% në shpenzimet e përgjithshme.

Në periudhën janar - shkurt 2025, Ministria e Transportit ka realizuar mjete në vlerë prej 375 milionë denarësh, përkatësisht 2.1% e buxhetit të përgjithshëm për vitin aktual. Realizimi i shpenzimeve kapitale si zë kryesor shënon 72.6% nga mjetet e përgjithshme të realizuara të këtij shfrytëzuesi buxhetor (272 milionë denarë ose 1.7% nga mjetet e përgjithshme të planifikuara).

Në këtë periudhë, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave ka realizuar mjete në vlerë prej 229 milionë denarësh, që paraqet 12.4% nga vlera e parashikuar për vitin 2025. Pagat dhe kompensimet (131 milionë denarë) janë zëri më i rëndësishëm nga mjetet e përgjithshme të realizuara të këtij shfrytëzuesi buxhetor me pjesëmarrje prej 57.2%, ndërsa u realizuan 15.4% nga planifikimi. Në bazë të shpenzimeve kapitale përfshijnë 29.0% nga shpenzimet e përgjithshme, ndërsa realizimi për këtë qëllim ishte 66 milionë denarë ose 10.8% nga buxheti i përgjithshëm për këtë qëllim.

Të dhënat e detajuara për secilin shfrytëzues buxhetor janë paraqitur në shtojcën statistikore në linkun në vijim (<http://finance.gov.mk/lëvizjet-ekonomike-afatshkurtra-ked-me/>).

4. SEKTORI SOCIAL


Personat e sapopunësuar dhe personat e regjistruar si të papunë në Agjencinë e Punësimit

Në muajin shkurt të vitit 2025, në Agjencinë e Punësimit ishin regjistruar gjithsej 30.560 marrëdhënie pune të sapokrijuara. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024, numri i përgjithshëm i personave të sapopunësuar është ulur për 11.5%.

Nga numri i përgjithshëm i personave të sapopunësuar, 42.8% janë persona të punësuar me kohë të pacaktuar, ndërsa pjesa tjetër me kohë të caktuar dhe për kryerjen e punëve sezonale. Nga numri i përgjithshëm i marrëdhënieve të sapokrijuara të punës, në muajin shkurt të vitit 2025, 14.0% janë nga evidenca e personave të papunësuar.


Numri i përgjithshëm i personave të papunësuar, në muajin shkurt të vitit 2025 ishte 141.979, nga të cilët 97.297

Grafiku 4.1: Pasqyra e personave të papunësuar (vlerat në njësi)



Burimi: APRMV

Grafiku 4.2: Pasqyra e punësimeve të reja (vlerat në njësi)



Burimi: APRMV



persona ishin kërkuar aktivë të punës, ndërsa pjesa tjetër prej 44.682 janë persona të papunë. Në bazë vjetore, numri i përgjithshëm i personave të papunë ka shënuar rënie për 7.7%, ndërsa duke filluar nga muaji maj i vitit 2021, ky numër shënoi rënie vjetore të vazhdueshme. Krahasur me muajin janar të vitit 2025, numri i të papunëve shënoi rritje për 1.032 persona.


Pjesa më e madhe e personave aktivë të papunë (58.7%) janë persona që jetojnë në qytet, ndërsa sipas strukturës gjinore, 48.2% janë meshkuj. Sipas shkallës së arsimit, pjesa më e madhe e personave të papunë, përkatësisht 68.7%, kanë arsim të mesëm jo të plotë ose më pak se aq, 23.7% me arsim të mesëm të përfunduar, ndërsa 7.6% kanë arsim të lartë ose më të lartë.

Sipas analizës së strukturës së moshës, 50.1% e personave të papunësuar bëjnë pjesë në grupin e moshës madhore nga 25 deri në 49 vjeç. Sipas kohës së pritjes së punësimit, 60.2% e personave të papunësuar, presin të punësohen prej 1 deri në 7 vjet, ndërsa 13.5% presin 8 vjet ose më shumë.

Pagat


Sipas njoftimit të Entit Shtetëror të Statistikave, paga mesatare nominale neto në muajin janar të vitit 2025 ishte 43.050 denarë dhe u realizua rritje vjetore prej 8.9%, ndërsa krahasuar me muajin dhjetor të vitit 2024 ishte më e ulët për 1.2%. Rritja më e theksuar e pagës mesatare neto në muajin janar të vitit 2025 u shënuar në këto sektorë: art, argëtim dhe rekreacion (15.6%), veprimtaria ndihmëse administrative dhe shërbyese (12.0%) dhe arsimi (11.4%). Në muajin janar të vitit 2025, pagat reale shënuan rritje vjetore prej 3.8%. Paga më e lartë mesatare neto në muajin janar të vitit 2025 u pagua në sektorin e informacionit dhe komunikimit (80.215 denarë), me ç'rast vlera më e lartë e pagës neto u pagua në veprimtarinë e programimit kompjuterik, konsultimeve dhe veprimtarive të ndërlidhura (99.367 denarë), ku më tej vijojnë veprimtaritë financiare dhe veprimtaritë e sigurimve me 57.903 denarë, sektori i furnizimit me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër

Grafiku 4.3: Paga mesatare neto
(normat vjetore të rritjes në %)




Burimi: ESHS

Grafiku 4.4: Paga mesatare neto sipas sektorëve
(normat vjetore të rritjes në %)



Burimi: ESHS

Grafiku 4.5: Paga mesatare neto sipas sektorëve, shkurt 2025 (në mijëra denarë)




Burimi: ESHS.



të koindicionuar me 56.598 denarë dhe sektori i minierave dhe guroreve me 56.233 denarë. Paga mesatare nominale bruto në muajin janar të vitit 2025 ishte 64.697 denarë dhe krahasuar me muajin e njëjtë të vitit 2024, ajo shënoi rritje për 8.9%, ndërsa në bazë mujore shënoi ulje për 1.4%. Rritja më e spikatur e pagës mesatare bruto në muajin janar të vitit 2025, krahasuar me muajin janar të vitit 2024 u shënuar në këto sektorë: arti, argëtimi dhe rekreacioni (15.1%), veprimtaria administrative, ndihmëse dhe shërbyese (12.1%) dhe arsimi (11.5%).

Pensionet

Në muajin shkurt të vitit 2025, në Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor ishin të regjistruar 342.313 pensionistë. Në muajin shtator të vitit 2024 u ndryshua Ligji i Sigurimit Pensional dhe Invalidor, sipas të cilit, që nga data 01.10.2024, kishte rritje lineare për të gjitha llojet e pensioneve për 2.500 denarë. Nga numri i përgjithshëm i pensionistëve, 71.1% ishin shfrytëzues të pensionit të pleqërisë, përkatësisht 243.318 pensionistë, 21.6% shfrytëzues të pensionit familjar, përkatësisht 73.925 pensionistë dhe 7.3% shfrytëzues të pensionit të invaliditetit, përkatësisht 25.070 pensionistë.



Pensioni mujor në muajin shkurt të vitit 2025 shënon 23.694 denarë, përkatësisht 17.9% më i lartë se muaji i njëjtë i vitit 2024⁴. Rritja e pensioneve, ndër të tjera, vjen si rezultat i harmonizimit të pensioneve në muajin mars, sipas metodologjisë që parasheh harmonizimin e pensioneve me model të kombinuar me rritje të pagës mesatare prej 50% dhe me rritje të kostos së jetesës prej 50%, sipas të dhënave zyrtare të ESHS-së. Sipas kësaj metodologjie, duke filluar nga muaji mars i vitit 2022, harmonizimi bëhet dy herë në vit, respektivisht në muajt mars dhe shtator.

Raporti i pensionit mesatar me pagën e paguar mesatare në muajin janar 2025 (të dhënat e fundit në dispozicion) ishte 55.1%.

Pensioni mesatar i pleqërisë në muajin shkurt të vitit 2025 ishte 25.326 denarë, pensioni mesatar invalidor ishte 21.268 denarë, ndërsa pensioni mesatar familjar 19.145 denarë. Për pagesën e pensioneve këtë muaj u harxhuan 8.002 milionë denarë, që paraqet 54.4% nga transfertat e përgjithshme sociale.

Tabela 4.1 Të dhënat e të ardhurave pensionale për muajin shkurt të vitit 2025			
Shfrytëzuesit e pensionit	Numri	Struktur a	Pensioni mesatar
pleqërie	243.318	71,1%	25.326,00
invalidor	25.070	7,3%	21.268,00
familjar	73.925	21,6%	19.145,00
Gjithsej	342.313	100,0%	23.709,00
Shfrytëzuesit në minimum pensionet bujqësore	34		13.432,00

⁴ Gjatë përlogaritjes së pensionit mesatar nuk janë përfshirë pensionet ushtarake dhe bujqësore.



Shfrytëzuesit e pensioneve

ushtarake

Pensione	722	32.247,00
Gjithsej	343.069	23.711,00

Burimi: Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Republikës së Maqedonisë së Veriut

5. SEKTORI MONETAR FINANCIAR

Në muajin shkurt të vitit 2025, Banka Popullore uli normën bazë të interesit për 0.20 p.p., në nivel prej 5.35%. Vendimi për lehtësimin e politikave monetare bazohet në vlerësimin e inflacionit në zhvillimet më të fundit të treguesve kryesorë makroekonomikë dhe në lëvizjet e favorshme në tregun devizor. Ky zvogëlim është në përputhje me politikën monetare të BQE-së, që filloi me uljen e normave të interesit që nga muaji shtator i vitit 2024.

Në muajin shkurt të vitit 2025, Banka Popullore e ruajti nivelin e normës së interesit të depozitave në dispozicion nëpërmjet depozitave njëditore dhe shtatëditore të disponueshme, respektivisht në nivel prej 3.95% dhe 4.00%.



Paratë primare

Në muajin shkurt të vitit 2025, paratë primare⁵ shënuan ulje për 0.4% në nivel mujor. Ulja e parave primare rezulton nga rënia parave të gatshme në qarkullim për 1.8%, ndërsa mjetet e përgjithshme likuide regjistruan rritje prej 1.1%.

Në muajin shkurt të vitit 2025, paratë primare u rritën në nivel vjetor për 10.1%, si pasojë e rritjes së parave të gatshme në qarkullim për 12.3% dhe rritjes së mjeteve të përgjithshme likuide për 7.9%.

Potenciali i depozitave⁶

Në muajin shkurt të vitit 2025, depozitat e përgjithshme në banka u rritën për 0.4% në nivel mujor. Analiza sektoriale tregon se krahasuar me



⁵ Paratë primare u përllogaritën si shumë e parave të gatshme në qarkullim (duke përfshirë edhe paratë e gatshme në arkë), rezervës së detyrueshme në denarë dhe në deviza dhe tepicës së mjeteve likuide mbi detyrimin e rezervës së detyrueshme.

⁶ BPRMV-ja publikoi të dhënat nga statistikave monetare, statistikave të institucioneve të tjera financiare dhe statistikave për normat e interesit, sipas metodologjisë së re. Ndryshimet metodologjike u realizuan për shkak të harmonizimit me rekomandimet e Manualit të sapublikuar dhe Udhëzuesit të statistikave monetare dhe financiare të FMN-së nga viti 2016 (MFSMCG – IMF, 2016) dhe Misionit teknik të FMN-së në fushën e statistikave monetare dhe financiare në BPRMV të vitit 2015.



muajin e kaluar, depozitat e ndërmarrjeve shënuan ulje për 1.0%, ndërsa depozitat familjare u rritën për 0.8%.

Nga aspekti valutor, në muajin shkurt të vitit 2025, krahasuar me muajin parapark, depozitat në valutën vendore regjistruan rritje për 1.2%, ndërsa depozitat në valutën e huaj regjistruan rënie për 0.7%.

Në muajin shkurt të vitit 2025, potenciali i përgjithshëm i depozitave realizoi rritje prej 11.1% në bazë vjetore. Sipas analizës valutore, depozitat në valutën vendore u rritën për 17.1%, ndërsa depozitat në valutën e huaj për 3.2%

Nga aspekti sektorial, depozitat e e ndërmarrjeve shënuan rritje prej 7.4% në nivel vjetor, ndërsa depozitat e familjeve u rritën prej 13.1%.

Tabela 5.1. Potenciali i depozitave dhe kreditë në sektorin privat

Potenciali i depozitave dhe kreditë në sektorin privat (shkurt 2025)	Në miliona denarë	Ndryshimi mujor	Ndryshimi vjetor
Potenciali i depozitave	595.277	0,4%	11,1%
Sipas valutës:			
Denarë	355,612	1,2%	17,1%
Valutë e huaj	239.665	-0,7%	3,2%
Sipas afatizimit:			
Afatshkurtra	220.442	-0,6%	1,2%
Afatgjata	150.940	1,3%	23,0%
Kreditë në sektorin privat	499.497	1,1%	11,5%
Sipas valutës:			
Denarë	308.085	1,6%	18,1%
Valutë e huaj	191.413	0,3%	2,3%
Sipas afatizimit:			
Afatshkurtra	78.314	2,4%	13,8%
Afatgjata	405.131	0,9%	11,8%

Burimi: BPRMV

Sipas afatizimit, depozitat afatshkurtra u rritën në nivel vjetor për 1.2%, ndërsa depozitat afatgjata regjistruan rritje për 23.0%.

Struktura valutore e depozitave vazhdon edhe më tej të mbetet stabile, me ç'rast pjesëmarrja e depozitave në valutë vendore dominon në bazën e depozitave, ku edhe këtë muaj pjesëmarrja shënon 59.7%

Kreditë e bankave

Në muajin shkurt të vitit 2025, kreditë e përgjithshme bankare në sektorin privat shënuan rritje për 1.1% në nivel mujor, në rrethana të uljes së kreditimit të ndërmarrjeve për 1.5% dhe rritjes së kreditimit të familjeve për 0.7%



Nga aspekti valutor, në nivel mujor kreditë në denarë dhe kreditë devizore shënuan rritje për 1.6%, përkatësisht 0.3%.

Në bazë vjetore, në muajin shkurt të vitit 2025, kreditë e përgjithshme shënuan rritje për 11.5%, në rrethana të rritjes së kredive të ndërmarrjeve dhe kredive ndaj familjeve për 14.3%, përkatësisht 8.9%. Kreditë në valutën vendore u rritën për 18.1%, ndërsa kreditë në valutën e huaj regjistruan rritje për 2.3%.


Nga aspekti i afatizimit, kreditë afatgjate shënuan rritje vjetore për 11.8%, ndërsa kreditë afatshkurtra për 13.8%.

Normat e interesit të bankave depozituese

Në muajin shkurt të vitit 2025, norma e përgjithshme e interesit të kredive shënoi ulje për 0.03% p.p., krahasuar me muajin paraprak dhe ajo shënon 5.18%. Norma e interesit të kredive në denarë shënoi ulje për 0.04 p.p., dhe shënon 5.68%, ndërsa norma e interesit të kredive divizore regjistroi rënie prej 0.22 p.p., dhe shënon 4.45%.

Në muajin shkurt të vitit 2025, norma e përgjithshme e interesit për depozitat shënoi rritje për 0.01 p.p., krahasuar me muajin e kaluar dhe shënon 2.19%. Norma e interesit për depozitat në denarë shënoi rritje për 0.01 p.p., dhe shënon 2.73%, ndërsa norma e interesit për depozitat devizore shënoi rritje për 0.03 p.p., dhe shënon 1.68%.

Norma e interesit për kreditë e sapoaprovuara në denarë shënon 4.84%, ndërsa për kreditë e sapoaprovuara devizore 3.81%. Normat e interesit për depozitat e sapopranuara në denarë dhe deviza shënojnë 2.82% dhe 2.01%.




Tregu i kapitalit

Në tregun e kapitalit, qarkullimi i përgjithshëm i bursës në muajin shkurt të vitit 2025 shënoi ulje për 29.7% në nivel mujor, në rrethana të rënies së qarkullimit të tregtimit klasik për 35.5%, ndërsa qarkullimi i transaksioneve bllok shënoi rritje për 4.1%.

Qarkullimi i përgjithshëm në bursë në muajin shkurt të vitit 2025, arriti në 667 milionë denarë, që paraqet ulje për 22.1% në nivel vjetor.

Në fund të muajit shkurt të vitit 2025, Indeksi i Bursës së Maqedonisë IBM-10 arriti në 10.660.7 pikë indeksi, me





ç'rast në nivel mujor shënoi ulje për 1.8%, ndërsa krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak indeksi shënon rritje për 56.5%.

Rezervat devizore

Vlera e rezervave devizore bruto në fund të muajit shkurt të vitit 2025 ishte 4.861,29 milionë euro dhe krahasuar me muajin paraprak shënoi ulje për 3.6%, ndërsa në raport me muajin shkurt të vitit 2024, rezervat devizore shënuan rritje për 11.8%.